DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-749/4
-VI-
Data Datum Date 27.10.2020

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada - Government
*Ministria e Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government*

| | | |
|---|---|---|
| Për: | **Xhafer Gashi,** Kryetar i Komunës së Obiliqit<br>**Burim Gërguri,** Kryesues i Kuvendit të Komunës së Obiliqit | |
| Kopje: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MPL<br>Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | **Goran Rakić,** Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MPL-së<br><br>**Rozafa Ukimeraj,** Sekretare e Përgjithshme e MPL-së | |
| Nga: | **Venera Çerkini,** Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave | Data: 15.10.2020<br>Nr.020-749 |
| Zyrtaret përgjegjës:<br>1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br><br>2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | **Xhevat Tafa,** Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave<br><br>**Vjosa Ahmetaj,** Zyrtare e lartë për monitorim të komunave | |
| Lënda: | Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Obiliqit | |
| Lloji i aktit: | □ Vendim i Kuvendit të Komunës | |

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 06/2020 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendim përfundimtar i Kuvendit të Komunës Nr. - I - 126 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Obiliqit në zonën kadastrale në Llazarevë |
| I miratuar më datë: 29.09.2020 |
| I parashtruar për shqyrtim në MPL më datë: 05.10.2020 |

Ministria e Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson së akti i komunës **<u>është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi</u>**.

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

| Nr. | Formulimi në aktin e komunës | Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim |
|---|---|---|
| 1. | Vendim përfundimtar i Kuvendit të Komunës Nr. - I - 126 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Obiliqit në zonën kadastrale në Llazarevë | Vendim përfundimtar i Kuvendit të Komunës - I - 126 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Obiliqit në zonën kadastrale në Llazarevë është në kundërshtim më Ligjin Nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, përkatësisht nenin 21 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të këtij Ligji ku sqarohet se të *dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës për rastet e veçanta, Procedurat e konkurrimit nuk zbatohen për këto raste: dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës me qëllim të realizimit të investimeve në sektorin e prodhimit të energjisë së ripërtritshme.*<br><br>Kjo dhënie e pronës në shfrytëzim afatgjatë në rastin konkret duhet të rregullohet konform legjislacionit në fuqi përkatësisht sipas nenit 21 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës si dhe nenit 25 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.<br><br>Andaj bazuar në të lartcekurat, Kuvendi i Komunës së Obiliqit, duhet ta rishqyrtoj këtë vendim dhe aktin ta harmonizoj në harmoni më legjislacionin në fuqi. |

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Pushtetit Lokal, kërkon nga Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës së Obiliqit që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

DALJSE-IZLAZNA-OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-749/4
Data Datum Date 27.10.2020

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*
*Ministria e Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government*

| | | |
|---|---|---|
| Za : | **Xhafer Gashi,** gradonačelnik Opštine Obilić<br>**Burim Gërguri,** predsedavjući Skupštine opštine Obilić | |
| Kopija: | Jedinici za administraciju dokumenata u MLS<br>Jedinici za administraciju dokumenata u opštini | |
| Preko: | **Goran Rakić,** zamenik premijera i ministar MLS<br>**Rozafa Ukimeraj,** generalna sekretarka MLS | |
| Od: | **Venera Qerkini,** rukovodilac Pravnog odeljenja i monitorisanje opština/ MLS | Dana, 15.10.2020.<br>Br. 020-749 |
| Odgovorni službenici:<br>1.Službenik za utvrđivanje zakonske procene<br>2.Službenik-ca za izradu zakonske procene | **Xhevat Tafa,** rukovodilac Odseka za monitorisanje opština<br><br>**Vjosa Ahmetaj,** viša službenica za montorisanje opština | |
| Predmet: | Zahtev za reviziju zakonitosti akta opštine Obilić | |
| Vrsta akta: | ☐ Odluka Skupštine opštine | |

Poštovani gradonačelniče,
Poštovani predsedavajući,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosova br.10/2019 o administrativnom razmatranju opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva, određenim osnovnim zakonima i Vladinom Uredbom br.06/2020 o oblastima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstva, Ministarstvo lokalne samouprave primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine, kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

| |
|---|
| Konačna odluka skupštine opštine br. - I - 126 o davanju na dugotrajno korišćenje nepokretne imovine opštine Obilić u katastarskoj zoni "Lazarevo" |
| Usvojena dana, 29.09.2020. godine, |
| Predložena za razmatranje u MLS, dana, 05.10.2020. godine,. |

Ministarstvo lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, ocenilo je da je, opštinski akt **u suprotnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi.**

U nastavku možete naći neslaganja opštinskog akta koji je dostavljen za razmatranje zakonitosti:

| Br. | Formulisanje u opštinskom aktu | Zakonska odredba sa kojom je opštinski akt u suprotnosti. |
|---|---|---|
| 1. | Konačna odluka skupštine opštine br. - I - 126 o davanju na dugotrajno korišćenje nepokretne imovine opštine Obilić u katastarskoj zoni "Lazarevo" | Konačna odluka skupštine opštine br. - I - 126 o davanju na dugotrajno korišćenje nepokretne imovine opštine Obilić u katastarskoj zoni "Lazarevo" u suprotnosti je sa Zakonom br. 06/L-092, o davanju na korišćenje i razmenu nepokretne imovine opštine, odnosno članom 21, stav 1, podstav 1.3 ovog zakona gde se objašnjava da: *davanje n akkorišćenje imovine opštine u posebnim slučajevima, postupci konkurisanja se ne primenjuju u sledećim slučajevima: "davanje na korišćenje nepokretne imovine opštine u cilju realizacije ulaganja u proizodnom sektoru obnovljive energije".*<br><br>Davanje na dugotrajno korišćenje imovine u konkretnom slučaju treba da se reguliše u skladu sa zakonodavstvom na snazi, odnosno prema članu 21, stav 1, podstav 1.3 Zakona br. 06/L-092, o davanju na korišćenje i razmenu nepokretne imovine opštine kao i članu 25, Uredbe VRK-a br. 09/2020, o utvrđivanju postupaka davanja na korišćenje i razemnu nepokretne imovine opštine.<br><br>Stoga, na osnovu gore pomenutih, Skupština opštine Obilić treba da revidira i uskladi akt sa zakonodavstvom na snazi. |

Na osnovu gore navedenog, Ministarstvo lokalne samouprave ***zahteva*** od Skupštine opštine i gradonačelnika opštine Obilić, preduzimanje konkretnih mera, kako bi se opštinski akt uskladio sa zakonskim odredbama na snazi, u roku od 30 dana od dana prijema zahteva za reviziju akta.

Ministarstvo lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za bilo kakvo objašnjenje u vezi sa ovom procenom.

DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE

Nr. -1- 126 Data 30.09.2020

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 12.14.2 ,17 pika c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 3 pika 1.4 , neni 6 pika 1.2 , neni 8 pika 1.3 dhe neni 11 pika 3.1 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092 nenit 44.1 dhe 47.3 Statutit të Komunës së Obiliqit ... datës 25.04.2016 dhe neni 39 i Rregullorës së Punës së Kuvendit nr.I-95... 2019 dhe propozimet e Kryetarit të Komunës ne II-1041,dt:23.09.2020 dhe propozim vendimi i Kryetarit të Komunës nr II-1088 dt.25.09.2020. Kuvendi Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 29.09.2020 ...

Data 05.10.2020
-01- 220-769

# VENDIM
# PËRFUNDIMTAR PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS SË OBILIQIT NË ZONËN KADASTRALE NË LLAZAREVË

I

Miratohet Vendim për dhënien e pronës së paluajshme të Komunës , në shfrytëzim afatgjatë ofertuesit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike SH.A - me adresë :Prishtinë .Rr:Bulevardi " Bill Clinton " Nr 5.

II

Sipas pikes I të këtij vendimi :

1. Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike SH.A është shfrytëzues i pronave të paluajtshme të Komunës

2. Pronat e Komunës gjenden në zonën kadastrale Llazarevë Njësia Kadastrale si në vijim P-72614041-00124-19 , me sipërfaqe të përgjithshme prej 17417 m², Vend i quajtur "Harëdhia" zone-Rrurale, zk.Llazarevë sipas Planit Zhvillimor Komunal parcela është Zonë Industriale. e evidentuar në Çertifikatën e Pronës në emër të P.SH.KK OBILIQ . Sipas nenit 11 pika 3.1 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092

3 .Shrytëzimi i pronës do të jetë për 99 vjet nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi . pas përfundit te këtij afati pronat i kthehen titullarit .

4 .Në pronën e paluajtëshme të Komunës do të ndërtohet objekti për nevoja të Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike SH.A

III

Dhënia në shrytëzim e pronave të paluajtëshme të cekur në pikën II , bëhet me kompenzim

IV

Të drejtat dhe obligimet e palëve do të rregullohen me kontratë , të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe shryetëzuesit të pronave të paluajtshme të Komunës

V

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtorati për Planifikim Urban,Pronë dhe Kadastër,Drejtorati për Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtorati për Inspekcion.

VI

Obligohet Drejtoria e Planifikimit Uraban , Kadastër dhe Pronë që pas përfundimit të zbatimit të procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës të regjistron në librat kadastral si prona të dhëna në shfrytëzim për periudhë afatgjatë.

VII

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyren e protokolit të MPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

**Kuvendi i Komunës së Obiliqit**
Nr. I-126 - , më 29 Shtator 2020

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal**

**Burim Gërguri**

T'i dërgohet
-Kryetarit
-Kryesuesit
-MPL
-DPUKP
-DMM
-DEZHF
-DI
-Palës
-Anëtarëve të Kuvendit
-Arkivit

Nr. -I- 126 Data 30.09.2020

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

U skladu sa članom 12,14.2, 17 tačka c) Zakona o lokalnoj samoupravi br. 03 / L-040, Službeni list Republike Kosovo br. 28 od 4. juna 2008, članova 3 tačka 1.4, člana 6 tačka 1.2, člana 8 tačka 1.3 i člana 11. tačka 3.1 Zakona o dodeljivanju na korišćenje i razmenu nepokretne imovine opštine br. 06 L-092 član 44.1 i 47.3 Statuta opštine Obilić br. I-34 od 25.04.2016. člana 39 Poslovnika o radu Skupštine br.I-95 od 29.06.2018 i predlozima predsednika opštine br.II-1041 od 23.09.2020. i predložene odluke predsednika br. II-1088 od 25.09.2020. , Skupština opštine na sastanku održanom 29.09.2020 donela sledeću:

Datum 05.10.2020

-VI- 020-749

# ZAKLJUČNU ODLUKU
# ZA IZDAVANJE NA DUGOROČNO KORIŠĆENJE NEPOKRETNE IMOVINE OPŠTINE OBILIĆ U KATASTARSKOJ ZONI LAZAREVO

I

Usvaja se Odluka o izdavanju nepokretnosti Opštine na dugoročnu upotrebu ponudaču Kosovskoj kompanijiza Distribuciju i Snabdevanje elektricnom energijom DD – sa adresom :Priština ,ul:Bulevardi " Bill Clinton " br 5.

II

Prema stavu I ove odluke:

1. Kosovsko preduzeće za distribuciju i snabdevanje električnom energijom DD je korisnik nepokretne imovine Opštine.

2. Opštinska imanja se nalaze u katastarskoj zoni Lazarevo, Katastarska jedinica kako sledi P-72614041-00124-19, ukupne površine 17417 m², mesto pod nazivom „Haredhia" ruralno područje, kz. Lazarevo prema opštinskom planu razvoja, parcela je industrijska zona, što je dokazano u imovinskom uverenju u ime DI SO OBILIC. Prema članu 11 tačka 3.1 Zakona o zakupu i zameni nepokretne imovine opštine br. 06 / L-092

3 . . Imovina će se koristiti 99 godina od datuma stupanja na snagu ove odluke, nakon isteka ovog roka imovina se vraća vlasniku.

4 . U nepokretnoj imovini opštine biće izgrađen objekat za potrebe Kosovske kompanije za distribuciju i Snabdevanje elektricnom energijom DD.

III

Izdavanje na koriscenje nepokretnosti navedeno u tački II vrši se uz naknadu.

IV.

Prava i obaveze stranaka regulisaće se ugovorom zaključenim između predsednika opštine i upravnika nepokretnosti opštine.

V.

O sprovođenju ove odluke brinu se gradonačelnik. Uprava za urbanizam, imovinu i katastar, Uprava za zaštitu životne sredine, Uprava za ekonomiju i razvoj i Uprava za inspekciju.

VI.

Direkcija za urbanizam, katastar i imovinu dužna je da se u katastarskim knjigama upiše kao svojina data na dugoročno korišćenje nakon završetka sprovođenja postupaka za dugoročno korišćenje nepokretnih dobara opštine.

VII.

Ova odluka stupa na snagu 15 dana nakon registracije u protokolarnoj kancelariji MLS, kao i 7 dana nakon objavljivanja na veb stranici opštine.

**Skupština Opštine Obilić**
br. I- 176 - , 29 septembra 2020 god.

**Presedavajući Skupštine Opštine**

**Burim Gërguri**

Dostaviti:
-Gradonačelniku
-Presedavajućem
-MPL
-DUPKI
-DZZS
-DPFR
-DI
-Stranki
-Članovima Skupštine
-Arhivi

Republika e Kosovës
Republika Kosovo- Republic of Kosova

Qeveria - Vlada - Government

---

Komuna Obiliq - Opština Obilić - Municipality Obiliq

Në mbështetje të nenit 58 pika (h), neneve 12, 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 11 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019,nenit 5 paragrafi 1 nënparagrafi1.3 dhe nenit 23 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 72 pika 1.1.8 Statutit të Komunës së Obiliqit Nr.I-34 të datës 25.04.2016 , Vendimit të Kuvendit Komunal Nr.I-47 dt.24.05.2016 për dhënien në shfrytzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Obiliqit për ngastrat Kadastrale Nr.00124/2 dhe nr.00126/1 zk.Llazarevë të cilat pastaj janë parcializuar dhe janë krijuar parcela të reja .Pas negociatave të Kryetarit të Komunës ku të pranishëm kanë qenë Bordi i Drejtorëve si dhe Përfaqësues të Kuvendit Komunal dhe deputetët në njërën anë dhe Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike SH.A. për Njësinë Kadastrale 00124-19 e cila është pjesë përbërse e Regjistrit të Pronave Komunale të cilat gjenden në web faqen e Komunës, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës që në mbledhjen e radhës, të miratojë këtë :

**PROPOZIM**
**VENDIM**
**PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS**

Neni 1

Me këtë Vendim i jepet në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite Investitorit - Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike SH.A. me adresë Bill Clinton Boulevard Nr.5, Prishtinë, njësia kadastrale si në vijim:

P-72614041- 00124-19, me sipërfaqe të përgjithshme prej 17417m$^2$, Vend i quajtur "Harëdhia", zk.Llazarevë sipas Planit Zhvillimor Komunal parcela është Zonë Industriale, e evidentuar në Çertifikatën e Pronës në emër të P.SH.KUVENDI KOMUNAL OBILIQ .

Neni 2

Qëllimi i dhënies në shfytëzim të pronave komunale është zhvillimi i aktiviteteve biznesore si dhe gjenerimi i vendeve te reja te punës sipas standardeve të përcaktuara me dispozitat ligjore

Neni 3

Obligohet Drejtorati për Planifikim Urban,Pronë dhe Kadastër që pas përfundimit të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës të regjistroj në librat kadastral si pronë e dhënë në shfrytëzim afatgjatë në afat prej 99 vitesh.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit, Drejtorati për Planifikim Urban,Pronë dhe Kadastër,Drejtorati për Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtorati për Inspekcion.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrim të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në webfaqe të Komunës.

**Arsyetim**

Baza ligjore për miratimin e këtij propozim-Vendimi është përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës Nr.06/L-092 , Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe të nenit 72 pika 1.1.8 Statutit të Komunës së Obiliqit Nr.I-34 të datës 25.04.2016.

Kryetari i Komunës duke u bazuar në nenin 11 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019 nenit 5 paragrafi 1 nënparagrafi1.3 dhe nenit 23 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës sipas autorizimeve të veta në prani të Bordit të Drejtorëve si dhe Përfaqësues të Kuvendit Komunal dhe deputetët me datë 02.09.2020 ka negociuar me Kompaninë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike SH.A. me adresë Bill Clinton Boulevard Nr.5, Prishtinë sipas kërkesës dhe Projektit ideor dhe sipas negociatave investitori planifikon që në njësinë e lartëcekur të realizoj investim të ri respektivisht të ndërtoj dy trafostacione me të gjitha paisjet e tjera energjetike e cila ka për qëllim furnizimin me energji elektrike të të gjithë zonës ku parashihet zonë industriale ku planifikon të investoj afër 1,516,000.0 €. Përveq rritjes së vlerës së Pronës Komunale nga ky projekt sipas Projektit ideor do të gjenerohen edhe vende të reja të punës ku përparësi do të kenë banorët e Komunës së Obiliqit .
Andaj me qëllim të realizimit të interesit publik, rritjes së vlerës së pronës publike komunale, krijimit të të hyrave vetanake në një anë dhe ofrimit të kushteve për krijimin e vendeve të reja të punës në anën tjetër përmes bërjes së politikave të punësimit, propozohet dhënia në shfrytëzim e pronës Komunale investitorit të lartëcekur dhe siç përcaktohet në nenin 1 të këtij propozim-Vendimi kërkojmë nga Kuvendi Komunal miratimin e këtij propozim-Vendimi.

KRYETARI I KOMUNËS

Xhafer Gashi

REPUBLIKA KOSOVA
OBILIQ
...ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE

Nr. / Br. II-1041 Data / Datum 23.09.2020

Republika e Kosovës
Republika Kosovo- Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Guvernment

---

Komuna Obiliq - Opštine Obilić - Municipality Obiliq

| | |
|---|---|
| Data | 23.09.2020 |
| Për | Burim Gërgurin – Kryesusi i Kuvendit Komunal - Obiliq |
| Nga | Xhafer Gashi – Kryetar i Komunës |
| Lënda | Kërkesë |

Kërkojm nga Kryesusi i Kuvendit Komunal në Obiliq që në mbledhjen e radhës së Kuvendit Komunës të futet në rend të ditës kërkesa për Dhënja në shfrytëzim të parcelave në zonen kadastrale në Llazarev duke u bazuar në kërkesat Kompanive .

Kësaj kërkese i bashkangjesim të gjitha kërkesat e skenuar të Kompanive dhe listen :

1. N.T.SH " Tre"
2. N.SH."A.M.C"
3. Kompania Kosore për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike – SH.A.
4. N.T.SH. "DIARI"
5. Bernas Therm SH.P.K
6. Bimer Group SH.P.K
7. A-D-E Group SH.P.K

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT / MINISTARSTVO EKONOMIJE I ŽIVOTNE SREDINE / MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT**
**AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY**

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-72614041-00124-19

| | |
|---|---|
| Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: | 05-2193-20 |
| Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: | 25.09.2020 - 15:10 |
| Komuna / Opština / Municipality: | Obiliq / Obilić / Obiliq |
| Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: | LLAZAREVË / LAZAREVO / LLAZAREVË |
| Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: | Obiliq / Obilić / Obiliq |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>($m^2$) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-72614041-00124-19 | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | Rural | 17417 | Ndarja e parceles ne bazë te kerkeses nga Komisioni Vlersues per dhënjen e pronës se paluajtëshme te Komunes (Nr.lendes 05-635/2016) studimi nga ZKK Obiliq. | 23.09.2016 | |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendbanimi - adresa<br>Prebivaliste - adresa<br>Resident - address | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address Details | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| HARËDHIA/HARËDHIA/HARËDHIA | | HARËDHIA | 23.09.2016 | |

Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture | Kullosat/Pašnjaci/pasture | Kullosë E Klasës 3/Pasnjak 3 Klase/3rd Class Pasture | 17417 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual / Individualna Drzavina / single possessor | P.SH.KUVENDI KOMUNAL OBILIQ | KCID2604066 | OBILIQ / OBILIĆ / OBILIQ / | | | 1/1 | Vendimi V-914/16 dt. 22.09.2016 Obiliq (Nr.lndes 05-639/16 | 23.09.2016 |

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT / MINISTARSTVO EKONOMIJE I ŽIVOTNE SREDINE / MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : OBILIQ
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Llazarevë

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m² |
|---|---|---|
| P-72614041-00124-19 | Parcelë / Parcela / Parcel | 17417 |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:1489

Punoi/Obradio/Created:
Data/ Data/Date: 25.09.2020
Koha/ Vreme/ Time: 03:27:24
Nënshkrimi/Potpis/Signature:
Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Aproved: Drejtor/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA OBILIĆ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE
Dalës-Izlazno
Nr. 11-1098 Data 28.09.2020
Br. Datum
OBILIQ-OBILIĆ

**Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova**

**Komuna e Obiliqit - Opština Obilić - Municipality Obiliq**

**Zyra e Kryetarit të Komunës**

**OFERTA E NEGOCIUAR – Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike – SH.A.**

Gjatë takimeve të realizuara në mes të Investitorit nga Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike – SH.A. me adresë Bill Clinton Boulevard Nr.5, Prishtinë, me Kryetarin e Komunës, z.Xhafer Gashi , bordit të Drejtorëve dhe asambleistëve të Kuvendit Komunal për marrjen e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim P-72614041-00124-19 , në zonën kadastrale në Llazarevë përmes negocimit me qëllim të investimit ashu siq e parasheh Ligji Nr.06/L-092 mbi Dhënien në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullorja (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës , u negociua oferta me pika kryesore të saj si në vijim të cilat më gjerësisht janë paraparë në planin ideor për investim :

- Planifikimi i ndërtimit të dy trafostacioneve me të gjitha paisjet e tjera energjetike e cila ka për qëllim furnizimin me energji elektrike të të gjithë zonës ku parashihet zonë industriale, ku vlera e investimeve në këtë projekt do të jetë afër 1,516,000 . 0 €;

- Përveq rritjes së vlerës së pronës komunale nga ky projekt do të gjenerohen edhe vende të reja të punës ku përparësi do të kenë banorët e Komunës së Obiliqit ;

- Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike – SH.A. (KEDS) pas këtij investimi do të ketë nevojë të punësojë punëtorë shtesë , përveq punëtorëve aktual e të cilët planifikohet të jenë nga Komuna e Obiliqit .

**Investitori**
**Kompania KEDS**

KEDS SH.A.

**Kryetari i Komunës**
**Xhafer Gashi**

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E OBILIQIT OBILIQ OBILIĆ OPŠTINA OBILIĆ REPUBLIKA KOSOVA

DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE

Dalës-Izlazna
Nr. I-47 Data 24.05.2016
Br. Datum
OBILIQ-OBILIĆ

Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

Në mbështetje të nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 44.1 dhe 47.3 të Statutit të Komunës dhe nenit 11 dhe 3.9 të Rregullores së punës të Kuvendit, nenit 6 lidhur me nenin 7, pika 3, e Ligjit Nr-04/L-144, për dhënjen në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluejtshme të Komunës ( "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.35/2012" ) nenit 5 lidhur me nenin 11, të Rregullores QRK, Nr.23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënjes në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluejtshme të Komunës, Kuvendi komunal në mbledhjen e mbajtur me dt.24.05.2016, mori këtë:

# VENDIM

I. Aprovohet Propozimi paraprak për dhënjen në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluejtshme të Komunës së Obiliqit, në zonën kadastrale Llazarevë dhe atë:
- Ngastra kadastrale nr.00124/2, në sipërfaqe prej 211369 $m^2$
- Ngastra kadastrale nr.00126/1, në sipërfaqe prej 27115 $m^2$

II. Obligohet DPUKP, dhe Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me Komisionin për vlerësimin e pronave të paluejtshme të Komunës, ti zhvilloj procedurat e konkurimit të hapur konform dispozitave të ligjit të cekur më lartë.

III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

T'i dërgohet
-Kryetarit,
-Nënkryetarit,
-Kryesuesit,
-MAPL-së,
-DPUKP,
- Këshilltarëve,
-Arkivit,

Kryesuesi i Kuvendit komunal
Adem Preniqi

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E OBILIQIT OPŠTINA OBILIĆ REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA OBILIC
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE
Dalës-Izlazno
Nr. 11-244 Data 19.04.2016
Br. Datum

OBILIQI - OBILIC

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ
MUNICIPALITY OF OBILIC

---

Në mbështetje të nenit 12,14 ,17 pika c) dhe nenit 58 pika h), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 6,7 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës e datës 22 nëntor 2012, neneve 11,12 të të Rregullores nr.23/2013 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 69 pika 4 Statutit të Komunës së Obiliqit Nr.01-51-2010 të datës 10.03.2010, Kryetari i Komunës propozon që Kuvendi i Komunës në Mbledhjen e radhës të miratojë këtë:

**PROPOZIM**

## VENDIM

## PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS SË OBILIQIT NË ZONËN KADASTRALE LLAZAREVË

### Neni 1

Me këtë Vendim ipen në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vitesh personave fizik dhe juridik paluajtshmëritë që gjenden në zonën kadastrale në Llazarevë në ngastrën kadastrale:

-Ngastra kadastrale P-72614041-00124-2 në vendin e quajtur "Harëdhia" me kulturë tokë bujqësore ,kullosë e kl.3-të me sipërfaqe prej 211369 m² e evidentuar në Çertifikatën e pronës nr.05-2467-2015 e dt.26.11.2015 ZK.Llazarevë e evidentuar si Pronë Shoqërore e Fshatit.

- Ngastra kadastrale P-72614041-00126-1 në vendin e quajtur "Harëdhia" me kulturë tokë bujqësore,kullosë e kl. 3-të me sipërfaqe prej 27115 m² e evidentuar në Çertifikatën e pronës nr.05-2467-2015 e dt.26.11.2015 ZK.Llazarevë e evidentuar si Pronë Shoqërore e Fshatit.

## Neni 2

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së lartëcekur është zhvillimi i veprimtarisë industriale respektivisht ndërtimi i ndonjë fabrike prodhuese apo përpunuese sipas standardeve të përcaktuara me dispozita ligjore.

## Neni 3

Sipas nenit 1 të këtij vendimi, prona ipet në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vitesh nëpërmjet konkursit publik të përcaktuar sipas Rregullores QRK. Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës.

## Neni 4

Procedurën e konkursit publik e zbaton Komisioni Vlerësues në bazë të Vendimit të Kuvendit Komunal Nr.I-136 të dt.31.10.2014, si dhe Rregullores QRK. Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës.

## Neni 5

Obligohet Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë që pas përfundimit të zbatimit të procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës të regjistron në librat kadastral si prona të dhëna në shfrytëzim për periudhë afatgjatë.

## Neni 6

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi,Kadastër dhe Pronë,Drejtoria e Inspekcionit si dhe Drejtoria për Mbrojtje të Mjedisit.

## Neni 7

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrim të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në webfaqe të Komunës.

## Arsyetim

Baza ligjore për të miratuar këtë propozim Vendim është përcaktuar me dispozitat e neneve 12,14 , 17 pika c) dhe neni 58 pika h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 6,7 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës e datës 22 nëntor 2012 ,neneve 11,12 të Rregullores nr.23/2013 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 69 pika 4 Statutit të Komunës së Obiliqit Nr.01-51-2010 të datës 10.03.2010.

Me qëllim të realizimit të interesit publik, rritjes së vlerës ekonomike të pronës komunale si dhe ruajtjes së mjedisit Komuna e Obiliqit ka planifikuar të jep në shfrytëzim afatgjatë në periudhë prej 99 vitesh pronat e paluajtshme që gjenden në zonën kadastrale në Llazarevë.

-Ngastra kadastrale P-72614041-00124-2 në vendin e quajtur "Harëdhia" me kulturë tokë bujqësore ,kullosë e kl.3-të me sipërfaqe prej 211369 m² e evidentuar në Çertifikatën e pronës nr.05-2467-2015 e dt.26.11.2015 ZK.Llazarevë e evidentuar si Pronë Shoqërore e Fshatit.

- Ngastra kadastrale P-72614041-00126-1 në vendin e quajtur "Harëdhia" me kulturë tokë bujqësore,kullosë e kl. 3-të me sipërfaqe prej 27115 m² e evidentuar në Çertifikatën e pronës nr.05-2467-2015 e dt.26.11.2015 ZK.Llazarevë e evidentuar si Pronë Shoqërore e Fshatit,ipen në shfrytëzim në mënyrë që subjekteve të ndryshme t'u mundësohet të ofertojnë për ushtrimin e veprimtarive të ndryshme të biznesit të cilat do të ndikonin në zhvillimin ekonomik të Komunës, hapjen e vendeve të reja të punës si dhe rritjen e vlerës ekonomike të pronës komunale.

KRYETARI I KOMUNËS

Xhafer Gashi

**Shtojcë :**

**-Çertifikatë –Njësia Kadastrale**

**-Kopja e Planit**

**-Orto-foto**

**'akim i Kryetarit të Komunës dhe deputetëve me Bizese për dhënien e Pronave Komunale në hfrytëzim -Prezatimi i Investimeve, Biznesi: KESCO, Datën: 02.09.2020**

| r | Emri | Mbiemri | Tel. | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|---|
| 1 | MUHAMET | MUSTAFA | 045 892 055 | [illegible] |
| 2 | Fatmir | Batemi | 045-356-07[illegible] | [illegible] |
| 3 | LAB'NOT | MIRONA | 045-859-54[illegible] | [illegible] |
| 4 | Abdyrrahman | Krasniqi | 045-163-800 | [illegible] |
| 5 | DRAGAN | JANČETOVIĆ | 045 688 606. | [illegible] |
| 6 | Emrer | Gashi | 044 167-905 | [illegible] |
| 7 | SHAIP | TALOJA | | [illegible] |
| 8 | Hakan | Berisha | | [illegible] |
| 9 | Burim | Fejzuli | 045/160-500 | [illegible] |
| 10 | BURBUQE | BARUTI | 049/790-341 | [illegible] |
| 11 | FARUK | GJOKAJ | 049/790449 | [illegible] |
| 12 | | | | |
| 13 | | | | |
| 14 | | | | |
| 15 | | | | |
| 16 | | | | |
| 17 | | | | |
| 18 | | | | |
| 19 | | | | |
| 20 | | | | |
| 21 | | | | |
| 22 | | | | |
| 23 | | | | |
| 24 | | | | |
| 25 | | | | |
| 26 | | | | |
| 27 | | | | |
| 28 | | | | |
| 29 | | | | |
| 30 | | | | |
| 31 | | | | |
| 32 | | | | |
| 33 | | | | |
| 34 | | | | |
| 35 | | | | |
| 36 | | | | |
| 37 | | | | |
| 38 | | | | |
| 39 | | | | |
| 40 | | | | |
| 41 | | | | |
| 42 | | | | |

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije
Ministry of Trade and Industry

ARBK

# CERTIFIKATË E REGJISTRIMIT
# CERTIFIKAT O REGISTRACIJI
# CERTIFICATE OF REGISTRATION

**810799364**

Numri Unik Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number

**Kompania Kosovare Për Distribuim Dhe Furnizim Me Energji Elektrike - SH.A.**

Emri biznesit / Naziv biznisa / Name of business

**Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike -SH.A.**

Emri tregtar / Trgovačko ime / Commercial name

| | |
|---|---|
| Lloji biznesit:<br>Poslovni tip:<br>Business type: | Shoqëri aksionare<br>Deoničarska društva<br>Joint Stock Companies |
| Adresa:<br>Adresa:<br>Address: | Bill Clinton Boulevard Nr.5, Prishtinë<br>Bill Clinton Boulevard Nr.5, Priština<br>Bill Clinton Boulevard Nr.5, Prishtinë |
| Data e regjistrimit:<br>Datum registracije:<br>Date of registration: | 11/09/2009 |

14/02/2019

Data / Date / Datum

Nënshkrimi / Signature / Potpis

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIČ - MUNICIPALITY OF OBILIC

## Formulari per kerkese apo ankese

**Drejtorati/Njesia**
Drejtoria për Planifikim Urban,Kadastër dhe Pronë

**Data** 27/07/2020

**Mos shkruani në këtë pjesë**

**Numri i protokolit**
05-463/04-0013825/20

**Afati i zgjedhjes**
26/08/2020

**Vendimi**

**1.Informatat personale te parashtruesit te kerkeses:**

**Emri dhe mbiemri**
Burbuqe Baruti

**Numri personal**
1004141233

**Adresa e vendbanimit**
Prishtinë, Rr Zagrebit nr.79

**E-mail Adresa**

**Numri i tel. fiks**

**Numri i tel. mobil**
049-790-341

**Vlera për pagesë:** 0,00

**2. Mënyra e pranimit**
Kërkesa

**Statusi i lëndës**
Ne proces

**3. Ju lutemi të shkruani kërkesën apo ankesën tuaj në detaje:**

Kërkesë

**4. Dokumentet e bashkangjitura:**

Nr. Lloji i dokumentit

**5. Dëshmia e aplikuesit për vërtetësi**

Unë Burbuqe Baruti vërtetoj se informatat e lartshënuara janë të vërteta.

(Nënshkrimi)

*Ju lutemi të kërkoni nga zyrtari/ja fletëdëshminë për dorëzimin e kësaj kërkese dhe dokumenteve të bashkangjitura

**Pranuar nga:** sala.paci

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIČ - MUNICIPALITY OF OBILIC

## Formulari per kerkese apo ankese

**Drejtorati/Njesia**
Kryetari Komunes

**Data** 27/07/2020

**Mos shkruani në këtë pjesë**

**Numri i protokolit**
02-070/05-0013826/20

**Afati i zgjedhjes**
26/08/2020

**Vendimi**

**1.Informatat personale te parashtruesit te kerkeses:**

**Emri dhe mbiemri**
Burbuqe Baruti

**Numri personal**
1004141233

**Adresa e vendbanimit**
Prishtinë, Rr Zagrebit nr.79

**E-mail Adresa**

**Numri i tel. fiks**

**Numri i tel. mobil**
049-790-341

**Vlera për pagesë:** 0.00

**2. Mënyra e pranimit**
Kërkesa

**Statusi i lëndës**
Ne proces

**3. Ju lutemi të shkruani kërkesën apo ankesën tuaj në detaje:**

Kërkesë

**4. Dokumentet e bashkangjitura:**

Nr. Lloji i dokumentit

**5. Dëshmia e aplikuesit për vërtetësi**

Unë Burbuqe Baruti vërtetoj se informatat e lartshënuara janë të vërteta.

(Nënshkrimi)

*Ju lutemi të kërkoni nga zyrtari/ja fletëdëshminë për dorëzimin e kësaj kërkese dhe dokumenteve të bashkangjitura

**Pranuar nga:** sala.paci

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo -Tax Administration of Kosovo

# VËRTETIM TATIMOR
# TAX VERIFICATION
# PORESKA POTVRDA

Administrata Tatimore e Kosovës verifikon se personi i identifikuar më poshtë:
Tax Administration of Kosovo certifies that the person identified below:
Poreska Administracija Kosova overava da dolje identifikaciono lice:

1000722703

Emri i personit:
Name of Person:
Ime lice:
Kompania Kosovare Për Distribuim Dhe Furnizim Me Energji Elektrike -

Numri Identifikues Personal:
Personal Identification Number:
Identifikacioni Lični Broj:

Numri Fiskal:
Fiscal Number:
Fiskalni Broj:
810799364

Komuna:
Municipality:
Opština:
PRISHTINË

Data:
Date:
Datum:
24.07.2020

Arsyeja e lëshimit:
Reasoning:
Razlog izdavanja:
Aplikim për vazhdim të linjave

ka këtë gjendje tatimore në ATK:
has the following tax position with the TAK:
ima sledeću poresko stanje u PAK:

Personi është i regjistruar në ATK dhe ka borxhe tatimore apo obligime tjera tatimore të pa shlyera
This person is registered with TAK and has tax debts or other tax obligations that are not satisfieds
Lice je registrovana u PAK i ima neisplačenih poreskih dugova i drugih poreskih obaveza

ATK vërteton se informatat e dhëna janë të sakta dhe të plota me datën e këtij vërtetimi tatimor, mirëpo, ky vërtetim nuk përjashton obligimet tatimore që mund të lindin në të ardhmen.

ATK certifies that this information is correct and complete as of the date of this verification, but this verification does not exclude future tax obligations.

PAK overava da su date informacije tačne i potpune sa datumom ove potvrde, ali ova podvrda ne isključuje poreska obaveza koja mogu nastati u budoćnosti.

Vërtetimi vlen 90 ditë nga data e lëshimit
The verification is valid for 90 days from the day it is issued
Potvrda vazi 90 dana od dana kada je izdata

Verifikimin e këtij vërtetimi tatimor, mund ta bëni në linkun -
Verification of this tax verification, you can do on the link - Verifikaciju ove poreske potvrde, možete uveravati i linku:
https://eVertetimi.atk-ks.org/TaxVer/ReadTaxVer

Nr.Formës VT - 2; Korigjuar më 30.04.2013

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
*REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO*

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË**
*OSNOVNI SUD PRIŠTINA*

***DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE EKONOMIKE***
*DEPARTMAN ZA EKONOMSKA PITANJA*

**Agj.nr. 3007/20**

**Me datë –Datuma 23.07.2020**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti për Çështje Ekonomike**, në bazë të
*OSNOVNI SUD U PRIŠTINI-Departman za privredna pitanja, na osnovu zahteva stranke, u smislu*
kërkesës së palës, në kuptim të nenit 12 paragrafi 2.10 i Rregullores për Organizimin e Brendshëm
*člana 12, stav 2.10 Pravilnika o unutrašnjoj organizaciji*
të Gjykatave e datës 4.1.2013, lëshon këtë:
*Sudova izdaje sledeće:*

## ÇERTIFIKATË

## UVERENJE

Në regjistrat e Departamentit për Çështje Ekonomike të Gjykatës Themelore në Prishtinë,
*U registrima Departmana za privredna pitanja Osnovnog suda u Prištini*
Nuk ka - evidencë se operatori ekonomik **Kompania Kosovare pë Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike- SH.A. Prishtinë, me numër biznesi 810799364.**

*nema dokaza da je ekonomski* operater

Nuk është - shpallur i falimentuar ose insolvent gjatë dy viteve të kaluara, dhe ndaj të njëjtit
*Nije proglašen pod stečaj ili nelikvidan u protekle dve godine, i protiv istog*

nuk është - e iniciuar procedura e falimentimit përkatësisht e likuidimit .
*nije – pokrenut postupak stečaja odnosno raspuštanja /likvidacije/.*

Kjo Çertifikatë lëshohet në kuptim të nenit 65 paragrafi 4 nënparagrafi 4.1 dhe 4.2 i Ligjit
*Uverenje izdaje se na osnovu člana 65 stav 4 podstav 4.1 i 4.2 Zakona*
Nr.04/L-042 për Prokurorimin Publik në Republikën e Kosovës.
*br.04/L-042 o Javnoj Nabavci Republike Kosova.*

E njëjta është kërkuar nga pala me qëllim të pjesmarrjes në **Nuk është në procedurë të falmentimit apo likuidimit.**
*Ista je tražena od stranke, sa ciljem učešća u tenderu*

dhe nuk mund të përdoret për qëllime tjera.
*i ne može se upotrebiti za druge svrhe.*

Taksa është paguar sipas Tarifës për taksa gjyqësore në shumë prej 5 €, e paraparë me nenin 12.17
*Taksa je plaćena po Tarifi za sudske takse u iznosu od 5 €, predviđeno članom 12.17*

të Udhëzimit Administrativ të KGJK-së, nr. 1/2017, në fuqi nga data 1.5.2017.
*Administrativnog Upustva SSK-a, br. 1/2017, na snazi od dana 1.5.2017god.*

Referenti i Gjykatës
Referent Suda
Afrim Ademi

INVESTITORI/INVESTOR: KEDS SH.A.

KOMPANIA KOSOVARE PER DISTRIBUIM DHE FURNIZIM ME ENERGJI ELEKTRIKE SH.A

KOSOVO ELECTRICITY DISTRIBUTION AND SUPPLY COMPANY J.S.C

KOSOVSKO PREDUZECE ZA DISTRIBUCIJU I SNABDEVANJE ELEKTRICNOM ENERGIJOM D.D

BULEVARDI BILL KLINTON NR. 5

PRISHTINE 10000, REPUBLIKA E KOSOVES

# PROJEKT IDEOR
# DETAIL DESIGN

EMRI I PROJEKTIT / PROJECT NAME:

NEW LOCATION OBILIQ_LAZAREVA -rev. 1.3

LOKACIONI/LOCATION: Lazareva, Obiliq

| | EMRI MBIEMRI/NAME SURNAME | NENSHKRIMI/SIGNATURE |
|---|---|---|
| PUNOI/PREPARED: | Perparim Thaqi Ing. dipl. ndert. | perparimthaqi |
| MATJE/MEASURE: | | |
| | | |
| KONTROLLOI/CHECKED: | Faruk Gjukaj ing. dipl. ndert. | farukgjukaj |
| APROVOI/APROVED: | | |
| | | |

REV. 1.3

last printed 11/04/2020

KOMPANIA KOSOVARE PËR DISTRIBUIM DHE FURNIZIM ME ENERGJI ELEKTRIKE
KOSOVO ELECTRICITY DISTRIBUTION AND SUPPLY COMPANY
KEDS - SH.A.
Nr. 5627 Dt. 27.07.2020
PRISHTINË/A 1

KEDS

Ndërtesa e Elektrokosovës
Bulevardi Bill Klinton nr.3
Prishtinë 10000
Republika e Kosovës

Elektrokosova Building
Bill Clinton Boulevard no.3
Prishtina 10 000
Republic of Kosovo

Për:
Kryetari i Komunës
z. Xhafer Gashi

Adresa:
Komuna e Obiliqit

DIVIZIONI I SHPËRNDARJES
PRISHTINË

Rr. Bill Klinton, No. 5,
Prishtina 10000,
Republika e Kosovës

www.keds-energy.com

Datë: 27.07.2020
Prishtinë

**Lënda : Kërkesë për marrje në shfrytëzim të tokës në zonën kadastrale Llazarevë nr.00124-19**

I nderuar zotëri Gashi,

Dëshirojmë të Ju informojmë se KEDS ka nevojë për një hapësirë, konkretisht marrje në shfrytëzim të tokës në zonën kadastrale Llazarevë parcelën me nr. 00124-19. Kërkesa e jonë është e bazuar në web-faqen komunale që ju keni publikuar disa prona për dhënje në shfrytëzim për 99 vite pronë komunale në zonën Kadastrale në Llazarevë Zonë Industriale. Andaj kërkojmë që të na jepet mundësia e negocimit direkt ashtu siq e parashef LIGJI PËR DHËNJEN NË SHFRYTËZIM DHE KËMBIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS LIGJI me Nr=06/L-092.
Në atë hapësirë-tokë planifikohet të ndërtohet:

1. Rrethimi i parcelës dhe sistemimet e nevojshme (heqja e humusit, mbushjet dhe stabilizimi i terrenit, vendosja e asfaltit, kubëzave prej betonit, etj.)

2. Trafostacioni i Ri i nivelit të tensionit 35/10(20)kV me dy transformatorë 8MVA së bashku me të gjitha pajisjet e tjera përcjellëse energjetike i cili do të ndërtohet me qëllim të furnizimit me energji elektrike të të gjithë zonës ku parashifet të jetë zonë industriale.

3. Linja nëntokësore 35kV, XHE 49-A 1x240/25mm² së bashku me të gjitha pajisjet energjetike nga TS ekzistues Mazgit 35/10(20)kV për furnizim me energji elektrike e deri te Trafostacioni i Ri 35/10(20)kV i cili planifikohet të ndërtohet brenda hapësirës së parcelës nr.00124-19 ZK Llazarevë.

4. Objekti i Elektroinxhinieringut – ku brenda këtij objekti do të punohen konstrukcione metalike si: trafo shtylla, shtylla metalike, konzolla, etj.

5. Objekti për Depo dhe Scrap – ku do të vendoset materiali i demoluar nga terreni.

6. Objekti për Zyre - ku do të vendoset stafi që do të punojë në këtë hapësirë.

7. Trafostacioni i Ri i nivelit të tensionit 10(20)/0.4kV me transformatorë 250kVA për nevojat vetanake.

KEDS pas këtij investimi do të ketë nevojë të punësojë punëtorë shtesë, përveç punëtorëve të KEDS_it. Punëtorët shtesë, planifikohet të jenë nga regjioni i Obiliqit.

Bashkangjitur keni:

1. Çertifikatën e regjistrimit të biznesit
2. Vërtetimin tatimor nga ATK-ja
3. Vërtetimin nga Gjykata Themelore Prishtinë
4. Projekti ideor së bashku me kostot e përafërta të investimit

Faleminderit për mirëkuptim

Me respekt,

Hasan ÖZ
Drejtor i Investimeve

KEDS PRISHTINË/A 01

KOSOVO ELECTRICITY DISTRIBUTION AND SUPPLY COMPANY
KEDS - SH.A.
Nr. 5627 Dt. 27.07.2020
PRISHTINË/A 1

KEDS

Ndërtesa e Elektrokosovës
Bulevardi Bill Klinton nr 3
Prishtinë 10000
Republika e Kosovës

Elektrokosova Building
Bill Clinton Boulevard no 3
Prishtina 10 000
Republic of Kosovo

Për:
Kryetari i Komunës
z. Xhafer Gashi

Adresa:
Komuna e Obiliqit

DIVIZIONI I SHPËRNDARJES
PRISHTINË

**Rr. Bill Klinton, No. 5,**
**Prishtina 10000,**
**Republika e Kosovës**

www.keds-energy.com

Datë: 27.07.2020
Prishtinë

**Lënda : Kërkesë për marrje në shfrytëzim të tokës në zonën kadastrale Llazarevë**

I nderuar zotëri Gashi,

Dëshirojmë të Ju informojmë se KEDS ka nevojë për një hapësirë, konkretisht marrje në shfrytëzim të tokës në zonën kadastrale Llazarevë parcelën me nr. 00124-20. Kërkesa e jonë është e bazuar në web-faqen komunale që ju keni publikuar disa prona për dhënje në shfrytëzim për 99 vite pronë komunale në zonën Kadastrale në Llazarevë Zonë Industriale. Andaj kërkojmë që të na jepet mundësia e negocimit direkt ashtu siq e parashef LIGJI PËR DHËNJEN NË SHFRYTËZIM DHE KËMBIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS LIGJI me Nr=06/L-092.
Në atë hapësirë-tokë planifikohet të ndërtohet:

1. Rrethimi I parcelave dhe sistemimet e nevojshme (heqja e humusit, mbushjet dhe stabilizimi I terenit, vendosja e asfaltit, kubezave prej betonit etj):

2. Trafostacioni I Ri i nivelit të tensionit 35/10(20) kV me dy transformatorë 8MVA sëbashku me të gjitha paisjet e tjera percjellëse energjetike i cili do të ndërtohet me qellim të furnizimit me energji elektrike të të gjithë zones ku parashihni te jetë zonë industriale.

3. Linja nëntokësore 35kV, XHE 49-A 1x240/25mm$^2$ sëbashku me te gjitha paisjet energjetike nga TS ekzistues Mazgit 35/10(20)kV për furnizim me energji elektrike të TS të RI 35/10(20) kVA i cili planifikohet të ndërtohet brenda hapësires se parceles nr. 00124-20:

4. Objekti i Elektoinxhinieringut – ku brenda këtij objekti do të punohen konstrukcione metalike si: trafo shtylla, shtylla metalike, konzolla etj.

5. Objekti për Depo dhe Scrap – ku do të vendoset materiali i demoluar nga terreni.

6. Objekti për Zyre – ku do të vendoset stafi qe do te punojë në këtë hapësirë.

7. Trafostacioni i Ri i nivelit të tensionit 10(20)/0.4kV me transformatorë 250kVA për nevojat vetanake.

KEDS pas këtij investimi do të ketë nevojë të punësojë punëtorë shtesë, përveç punëtorëve të KEDS_it. Punëtorët shtesë, planifikohet të jenë nga regjioni i Obiliqit

Bashkangjitur keni:

1. Certifikatën e regjistrimit të biznesit
2. Vërtetimin tatimor nga ATK-ja
3. Vërtetimin nga Gjykata Themelore Prishtinë
4. Projekti ideor së bashku me kostot e përafërta të investimit

Faleminderit për mirëkuptim

Me respekt,

Hasan ÖZ
Drejtor i Investimeve

KEDS PRISHTINË/A 01

II) Procesverbal 12.08.2020

Shqyrtimi i kërkesëve të ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronës, në Zonën Industriale, në fshatin Llazarevë

* „KEDS" → Barbuqe Baruti → përveç garancionit bankare mungojnë, tjerat të plotësuara

)

Procesmbajtës-ja

Republika e Kosovës
Republika Kosovo- Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Guvernment
Komuna e Obiliqit - Skupština Obilić - Municipality Obiliq

**Takim pune me Drejtorët për kotrollimi e dokumentave të Bizeseve që ka aplikuar për marrjen e pronave Komunale në shfrytëzim.** KED-s **Datën: 12.08.2020**

| Nr | Emri | Mbiemri | Tel. | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Abdyrrahman | Krasniqi | 045-163-800 | [signature] |
| 2 | Zarife | Behluli | 045 163 700 | [signature] |
| 3 | [illegible] | [illegible] | 044 238 062 | [signature] |
| 4 | FITORE | HAFHANI | 045/163-300 | [signature] |
| 5 | Lendita | Behluli | 044-163-602 | [signature] |
| 6 | BURIM | ISMAILI | 045 130 888 | [signature] |
| 7 | | | | |
| 8 | | | | |
| 9 | | | | |
| 10 | | | | |
| 11 | | | | |
| 12 | | | | |
| 13 | | | | |
| 14 | | | | |
| 15 | | | | |
| 16 | | | | |
| 17 | | | | |
| 18 | | | | |
| 19 | | | | |
| 20 | | | | |
| 21 | | | | |
| 22 | | | | |
| 23 | | | | |
| 24 | | | | |
| 25 | | | | |
| 26 | | | | |
| 27 | | | | |
| 28 | | | | |
| 29 | | | | |
| 30 | | | | |
| 31 | | | | |
| 32 | | | | |
| 33 | | | | |
| 34 | | | | |
| 35 | | | | |
| 36 | | | | |
| 37 | | | | |
| 38 | | | | |
| 39 | | | | |
| 40 | | | | |
| 41 | | | | |
| 42 | | | | |

I)

'Procesverbal 05.08.2020

* Hapjene takimit e bëri kryetari Xhafer Gashi, i cili
olli rendin e ditës me procedurat për dhënien në
shfrytëzim.

* Drejtori i DPUKP-së, vazhdoj rendimin duhje si dhe
nikoj nga pala ofertuese znj. Burbuqe Bauti (KEDS)
të bëjë prezentimin e tij për projektin të cilin do
ta implementojnë në zonën Industriale në fshatin Hareina

* z. Faruk Gjinolaj rendon projektin në fjalë me të cilin
do të bëhet vendosja e kabllit nën tokësor në bardar
me stacionin dhe trafon, për komplet zonën Industriale
me Energji Elektrike. Ky projekt kap shumën rreth
500 mijë euro vetëm stacioni dhe kabllot ndërsa
vlera totale kap shumën mbi 1 milion e 500
mijë euro. Ky projekt është pikë kyçe për të gjitha
bizneset, me energji elektrike.

* Kryetari → qlau domamik duhet të sillet nga pala mejë
është obligator. Po ashtu çështja e pronësisë ashtë prioritet
i yni gjithashtu të merret parasysh nga pala nëse veç
është për fitues.

Procesmbajtës-ja

[signature]

Republika e Kosovës
Republika Kosovo- Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Guvernment
Komuna e Obiliqit - Skupština Obilić - Municipality Obiliq

## Takim pune i Kryetarit të Komunës dhe Drejtorëve me Bizese për dhënien e Pronave Komunale në shfrytëzim. Biznesi: KEDS, Datën: 08.05.2020

| Nr | Emri | Mbiemri | Tel. | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|---|
| 1 | BURBUQE | BARUTI | 049 /790-341 | [illegible] |
| 2 | FARUK | GJUKAJ | 049/790449 | [illegible] |
| 3 | Xhafer | Gashi | 045 123999 | [illegible] |
| 4 | Naim | Miftari | 045-163-100 | [illegible] |
| 5 | BURIM | ISMAILI | 045-130-388 | [illegible] |
| 6 | FITORE | HASHANI | 045-163-300 | [illegible] |
| 7 | Abdyrrahman | Krasniqi | 045-163-800 | [illegible] |
| 8 | Arlon | Berisha | 044-238062 | [illegible] |
| 9 | | | | |
| 10 | | | | |
| 11 | | | | |
| 12 | | | | |
| 13 | | | | |
| 14 | | | | |
| 15 | | | | |
| 16 | | | | |
| 17 | | | | |
| 18 | | | | |
| 19 | | | | |
| 20 | | | | |
| 21 | | | | |
| 22 | | | | |
| 23 | | | | |
| 24 | | | | |
| 25 | | | | |
| 26 | | | | |
| 27 | | | | |
| 28 | | | | |
| 29 | | | | |
| 30 | | | | |
| 31 | | | | |
| 32 | | | | |
| 33 | | | | |
| 34 | | | | |
| 35 | | | | |
| 36 | | | | |
| 37 | | | | |
| 38 | | | | |
| 39 | | | | |
| 40 | | | | |
| 41 | | | | |
| 42 | | | | |



## Vjosa Ahmetaj

**From:** Vjosa Ahmetaj
**Sent:** 19 October 2020 09:31
**To:** Burim Gerguri
**Cc:** Venera Çerkini; Xhevat Tafa; Azize Zeneli
**Subject:** Njoftim.....

I nderuar,

Ju njoftoj se për shkak të disa procedurave dhe vet natyrës së akteve do të vonohet vlerësimi i ligjshmërisë së akteve të miratuara në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Obiliqit të datës 29.09.2020, andaj ju lutem të mos publikohen aktet deri sa të pranoni vlerësimin e ligjshmërisë nga MPL.

Ju falënderojmë për mirëkuptim dhe bashkëpunim!..

---

Me respekt,
Vjosa Ahmetaj